

RAPORTI I TAKIMIT VJETOR TË KUVENDIT TË ANËTARËVE

- Data dhe vendi:** 28 shkurt 2018, Prizren
- Pjesëmarrësit:** *Anëtarët:* Taulant Gutaj (kryesues i Kuvendit të Anëtarëve për vitin 2018), Artnet Haskuka, Ajtene Krasnqi, Kreshnik Basha, Dren Marseli, Enver Batiu, Flaka Siqeca, dhe Venera Goxha, Refet Bushati dhe Besar Haxhibeqiri. Antigona Shestan, Ajete Kërqeli dhe Aliriza Arënliu në pamundësi për të qenë prezent dërguan votën e tyre përmes emailit.
- Stafi i organizatës:* Edon Mullafetahu (drejtor ekzekutiv), Admir Istrefi (koordinatori i financave), Valon Xhabali (koordinatori programi)
- Agjenda e takimit:** *Hapje e takimit dhe mirëseardhje*
Miratimi i rendit të ditës
Zgjedhja e kryesuesit të ri të Kuvendit të Anëtarëve
Prezantimi i raporteve 2017, diskutim dhe miratimi i tyre
Prezantim i Planit të Punës 2018, diskutim dhe miratim
Çështje operationale të organizatës
Mbyllja e takimit

Hapje e takimit

Takimi u hap nga Venera Goxha, Kryesuese e Kuvendit të Anëtarëve për vitin 2017. Rendi i ditës u miratua pa ndryshim. Për Kryesues të ri të Kuvendit të Anëtarëve u nominua dhe u votua unanimisht Taulant Gutaj, i cili do të mbajë këtë pozitë gjatë tërë vitit 2018.

Prezantimi, diskutimi dhe miratimi i raporteve të punës dhe financiare për vitin 2017

Raporti vjetor i punës për vitin 2017 u prezantua nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Ky raport përfshin: projektet e realizuara gjatë vitit, iniciativat dhe aktivitetet e tjera, publikimet, partneritetet dhe të arriturat e punës një vjeçare. Pas raportit vjetor të punës, koordinatori i financave i organizatës e prezantoi raportin vjetor financiar. Ky raport përfshin: listën e projekteve dhe donatorëve bashkë me shumat e përkrahjes, të hyrat gjatë vitit 2017 në bazë të projekteve/donatorëve, si dhe shpenzimet gjatë vitit 2017.

Prezantimi i raportit të punës dhe atij financiar u pasua me diskutim të anëtarëve të Kuvendit. Pas diskutimeve rreth të dy raporteve, anëtarët e Kuvendit votuan veç e veç për secilin prej këtyre raporteve. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent (dhe tre anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), në votime të veçanta, u miratuan Raporti Vjetor i Punës 2017 dhe Raporti

Financiar 2017. Të dyja dokumentet (raportet), në formën e tyre përfundimtare të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve do të nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve (në emër të Kuvendit të Anëtarëve) dhe drejtori ekzekutiv i organizatës (në emër të stafit të EC Ma Ndryshe) dhe do të publikohen në web-faqen e organizatës.

Prezantimi, diskutimi dhe miratimi i Planit të Punës dhe Planit Financiar për vitin 2018

Plani i Punës për vitin 2018 u prezantua nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Plani vjetor i punës është në harmoni me Strategjinë e organizatës, dhe i strukturuar në bazë të qëllimeve strategjike dhe riorganizimit programor të organizatës. Plani i Punës 2018 parasheh:

- Vazhdimin e zbatimit të disa projekteve të cilëve u ka mbaruar mbështetja financiare, për të siguruar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri të punës dhe ndikimit,
- Qasjen strategjike të thellimit (profesionalizimit të mëtejshëm) në projektet aktuale dhe potencialisht, zgjerimit të tyre edhe në komunat e tjera (pasi që ato janë pilotuar në Prizren),
- Realizimin e shtatë (7) projekteve, përfshi projektet aktuale të organizatës dhe disa të reja.

Pas prezantimit të planit të punës, koordinatori i financave i organizatës e shpali planin financiar për vitin 2018. Sipas këtij plani me shtatë kategori të gjëra buxhetore, organizata synon të realizojë buxhet vjetor prej 257,310 EUR gjatë vitit 2018. Pjesë e Planit Financiar 2018 është edhe lista e burimeve të të hyrave (projektet, donatorët dhe shumat).

Prezantimi i planit të punës dhe planit financiar për vitin 2018 u pasua me diskutim të anëtarëve të Kuvendit. Diskutimi u përqendrua në nevojën për konsolidimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të punës së organizatës, përfshi projektet, programet, qëllimet strategjike dhe planet vjetore. Pas diskutimeve rreth të dy dokumenteve, anëtarët e Kuvendit votuan veç e veç për secilin prej tyre. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezent (dhe tre anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), në votime të veçanta, u miratuan Plani i Punës 2018 dhe Plani Financiar 2018. Të dyja dokumentet, në formën e tyre përfundimtare të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve do të nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve (në emër të Kuvendit të Anëtarëve) dhe drejtori ekzekutiv i organizatës (në emër të stafit të EC Ma Ndryshe) dhe do të publikohen në web-faqen e organizatës.

Shqyrtimi i pozitës së anëtares Flaka Siqeca në Kuvendin e Anëtarëve të EC

Në takim u diskutua edhe çështja nëse ekziston konflikt interesi që znj. Flaka Siqeca të vazhdoj punën e saj si anëtare e Kuvendit; duke marr parasysh që tani ajo e ushtron funksionin e Drejtoreshës për Shëndetësi në Komunën e Prizrenit.

Pas shqyrtimit të Statutit të EC Ma Ndryshe, Ligjit me Nr. 04/L-57 për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare si dhe përshkrimin të detyrave dhe përgjegjësisë të Drejtoreshës së Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit u vërtetua që nuk ka asnjë konflikt të interesit që znj. Flaka Siqeca të vazhdojë ushtrimin e funksionit të anëtares së Kuvendit të EC.

Andaj Kuvendi i Anëtarëve vendos që ajo mund të vazhdoj punën e saj si anëtare e rregullt e kuvendit të EC Ma Ndryshe.

Në rast të ndryshimit të rrethanave, përgjegjësive apo edhe fushëveprimit të organizatës, e cila mund të rezultoj me krijim të konfliktit të interesit për Znj. Siqeca, Kuvendi vendos që ajo nuk mund të merr pjesë në diskutime apo edhe votim deri në takimin e radhës së Kuvendit.

Diskutime dhe vendime të tjera

- Anëtarët e organizatës do të njoftohen për punën e organizatës përmes raporteve të rregullta narrative dhe financiare të cilat do t'i pranojnë nga drejtori ekzekutiv,
- Sigurimi i cilësisë së hulumtimeve dhe raporteve (publikimeve) duhet të jetë prioritet për punën e organizatës. Ngritja dhe zhvillimi i programit të hulumtimeve është kusht i domosdoshëm për rritjen e profesionalizmit dhe kompetencës hulumtuese,
- Në çdo moment duhet të sigurohet baraspeshë adekuate mes shpenzimeve për aktivitete dhe për burime njerëzore.